

Të dashur prindër!

Në moshën rreth 18 vjeçare, të rinjtë përballen me vendimin për të studiuar ose për të marrë një profesion. Shpesh nuk është fare e lehtë të bësh zgjedhjen e duhur. Programi 18plus i ndihmon në marrjen e këtij vendimi. I mbështet dhe i shoqëron studentët në këtë përgatitje për botën e profesionit dhe për botën e studimit. Këtë program e ka zhvilluar Ministria Federale e Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit së bashku me ekspertët.

ÇFARË MUND TË BËJË 18PLUS?

18plus inkurajon të rinjtë që të mendojnë për karrierën e tyre dhe zgjedhjen e studimeve ndërkohë që janë ende në shkollë. Studentët dhe këshilltarët arsimorë që gjenden në vendin e shkollës, ndihmojnë për të zbuluar pikat e forta personale dhe për të arritur në thelbin e interesave. Studentët dhe studentet njihen gjithashtu me shumë informacione dhe shërbime të mëtejshme këshilluese.

PO ÇFARË BËJNË STUDENTËT DHE STUDENTET NË 18PLUS?

Në programin 18plus, studentët kryesisht i bëjnë vetes pyetjet e mëposhtme:

- » A e di unë tashmë se çfarë dua të bëj pas maturës?
Sa i/e sigurt jam për vendimin tim?
- » Cilat janë pikat e mia të forta?
- » Çfarë është e rëndësishme për mua? Cilat janë interesat e mia?
- » Çfarë dua të arrij në vitet e ardhshme apo në jetë?
- » Ku mund të fitoj përvojë praktike?
- » Cilat janë hapat e mi të ardhshëm?
- » Si të gjej informacionin e duhur për zgjedhjen e profesionit dhe studimeve?

Një pyetje veçanërisht e rëndësishme është: Kush mund të më mbështesë në vendimin tim për një profesion ose për studime? Këtu hyni në lojë ju si shoqëruesi apo shoqëruesja! Ne ju ftojmë të mbështesni zgjedhjen tuaj të profesionit apo studimeve me fjalë dhe vepra. Sugjerime të vlefshme do të gjeni në faqen e internetit www.18plus.at.

Dr. Andrea Fraundorfer
Menaxhere programi BMBWF

Dr. Paul Wilkens
Menaxher programi BMBWF

Dr. Mag. Marion Kern
Drejtuese e zyrës së programit 18plus/BMBWF

Zyra e programit 18plus / BMBWF

Ministria Federale e Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit
18plus@bmbwf.gv.at
www.bmbwf.gv.at / www.18plus.at